



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PEJË**  
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

**P nr.732/16**

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA THEMELORE NË PEJË D.P, gjyqtari Sejdi Blakaj me sekretaren juridike Gjyljeta Çorkadiu , në lëndën penale kundër të pandehurit A.N , sipas aktakuzës së PTH-së D.P. në Pejë PP/IL.nr .2135/15 të dt.01.8.2016, për shkak të veprës penale: vjedhje e pyllit nga neni 358 par 2të KPRK-së, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar, publik dhe me gojë, të mbajtur në praninë e të pandehurit A.N dhe të prokurorit të shtetit Ardita Beqiraj me dt.16.8.2017 ka marrë dhe botërisht ka shpallë këtë :

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri A. N i lindur me dt..... në fsh. .... Komuna ....., me vendbanim në ..... Komuna e ....., i biri U dhe nënës B e gjinisë M, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në liri.**

**ËSHTË FAJTOR**

Për arsye se:

Me dt. 30.9.2015 , rreth orës 16:30 minuta , në Rekë të Allagës Komuna e Pejës , në territorin e parkut ndërkombëtar “Bjeshkët e Nemuna” , me qëllim të vjedhjes ka bërë prerjen e trungjeve të llojit Breu , me vëllim të përgjithshëm prej 3.90 m<sup>3</sup> , në atë mënyrë që i pandehuri të njëjtën masë drunore e ka prerë n pyllin privat të të dëmtuarit Rr. H. N nga i njëjti fshat dhe atë në ngastrën numër 502ZK Reka e Allagës , e ku më pas kompetentët kanë konstatuar masën drunore të prerë.

-me çka ka kryer veprë penale :vjedhje e pyllit nga neni 358 par 2 të KPRK-së

Prandaj gjykata të pandehurin konform nenit 41, 42,43,46 ,49 ,50,51,52, 76 dhe nenit 358 par 2 të KPRK-së.

**E GJYKON :**

1.Me dënim me gjobë në lartësi prej 200 euro , e të cilën gjobë i pandehuri fare nuk do ta paguaj nëse në afat prej 1( një )viti nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale .

Dhe :

**Me dënim burgu,**

2.Në atë mënyrë që ia përcakton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 3 muajsh , e të cilin dënim i pandehuri fare nuk do ta vuaj nëse në afat prej 1 viti nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

pandehuri për shkak të gjendjes së varfër ekonomike lirohet nga pagimi i paushallit gjyqësorë

E dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Masa drunore e sekuestruar prej 3.90 m3 -KONFISKOHET

Shpenzime procedurale nuk ka pasur

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë me dt.01.8.2016 kundër të pandehurit A.N ka ngritë aktakuzë PP/II. nr.2135/15 për vepër penale : vjedhje e pyllit nga neni 358 par 2 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë të pandehurin ta shpallë fajtorë , ta dënoj sipas ligjit dhe ta obligoj në pagimin e shpenzimeve procedurale .

Në shqyrtimin fillestarë i pandehuri – pasi që paraprakisht i është lexuar aktakuza , është njoftuar me të drejtat dhe detyrimet procedurale dhe pasojat e pranimi përkatësisht të mos pranimi të fajësisë- e ka pranuar fajësinë dhe ka manifestuar keqardhje për atë që i ka ndodhur. Këtë pranim fajësie gjyqtari – pasi që paraprakisht e ka marrë pëlqimin e prokurorit të shtetit, i bindur se pranim fajësinë i pandehuri e ka bërë ashtu siç e parasheh ligji – vullnetarisht dhe pa u ndikuar nga askush dhe në asnjë mënyrë -e ka pranuar .

Meqenëse i pandehuri e pranoj fajësinë gjyqtari kaloj në marrjen e vendimit lidhur me llojin dhe lartësinë e masës ndëshkuese , me ç rast i pati parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Rrethanë rënduese në rastin konkret gjyqtari nuk ka gjetur , kurse nga ato lehtësuese ka çmuar : pranimin e singertë të fajësisë , pendimin e thellë për këtë gjë, qëndrimin korrekt në gjykatë, pa dënueshmërinë e mëparshme gjendjen e varfër ekonomike i pandehuri është mbajtës i familjes prej 8 anëtarësh, dhe kësaj gjyqtari mendon se edhe me një vendim si në dispozitivin e aktgjykimit ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me neni 41 të KPK-së .

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 453 të KPPRK-së.

Vendimi mbi konfiskimin masës drunore është marrë konform nenit 62 par 1 1 dhe 1 pika 2.7 . dhe neni 69 par 1 të KPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit në kontestin e rregullt civil është marrë konform nenit 463 të KPPRK-së .

Nga sa u tha më lartë konform nenit 365 të KPPRK-së u vendos si më lartë.

Nga Gjykata Themelore në Pejë D.P. datë.16.8.2017

Sekretarja juridike  
Gjyljeta Çorkadiu

Gjyqtari  
Sejdi Blakaj

### KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi lejohet  
Ankesa në afat prej 15 ditësh nga  
Dita e marrjes , Gjykatës të Apelit në Prishtinë  
E përmes kësaj Gjykate .